

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Gjimnazi dhe gjimnazi gjuhësor

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përbëhet nga tri pjesë: teksti joletrar dhe njohuritë gjuhësore, analiza e tekstit letrar, dhe puna me shkrim (eseja)

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

1. Për 20 pyetjet me zgjedhje (alternativa), pasi të keni qarkuar alternativën e saktë në test, duhet të mbushni rrrathët përkatës të tabelës në fletëpërgjigje.

Lexoni me kujdes udhëzimet e dhëna në fletëpërgjigje.

2. Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet duhet të shkruhen brenda hapësirës së dhënë.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	14	15	16	17	25	26	27	28	29
Pikët									
Kërkesa	30	31	32	33	34 (a)	34 (b)	34 (c)	34 (d)	
Pikët									

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I

Teksti joletrar

Peshkaqenët

Janë të pakta kafshët që u kallin tmerr njerëzve më shumë se peshkaqenët. Anembanë botës çdo vit ndodhin mesatarisht 75 sulme peshkaqenësh të paprovokuara dhe gati 10 prej tyre janë fatale. Këto sulme që bëjnë bujë, dhe imazhi i keq që përcjellin filmat për peshkaqenin, bëjnë të krijohet ideja se ai është njerëzshëm. Sigurisht, me peshkaqenët nuk bëhet shaka.

Është konstatuar se peshkaqenët sulmohen vazhdimisht nga njerëzit. "Çdo vit kapen 100 milionë peshkaqenë, pra aq shumë, sa që po t'i vëmë në radhë, duke bashkuar hundën e njërit me bishtin e tjetrit, do ta qarkonin globin pesë herë", - thotë në revistën *Premier* një studiues pranë organizatës *Argos* të shkencëtarëve këshillues për botën detare. Shtoji këtij rrëtimi lindjet që në përgjithësi janë të pakta, pjekurinë e ngadaltë seksuale, periudhën e gjatë të shtatzënisë, bashkë me ndotjen e zonave ku rritin të vegjlit, dhe vihet re si pasojë zvogëlimi i shpejtë i popullatës së peshkaqenëve. Shkencëtarët vërejnë se, në rast se do të pakësoheshin shumë, do të duheshin vite që ata ta merrnin veten.

Shumica e peshkaqenëve kapen për t'u marrë pendët notuese, që disa aziatikë i vlerësojnë shumë, pasi besohet se kanë veti të larta mjekësore. Supa me pendë peshkaqeni është një ushqim i rrallë e i shtrenjtë dhe një tas mund të kushtojë edhe 110 euro. Sipas studiuesve të tregut, furnizimi i tregut fitimprurës aziatik ka çuar në praktikën mizore dhe shpërdoruese të "gjuetisë së pendëve", që do të thotë se peshkaqenëve të gjallë u priten pendët dhe hidhen prapë në oqean, ku ngordhin nga uria ose ngaqë mbyten.

[1] Shumë peshkaqenë po zhduken nga brigjet e Afrikës dhe çuditërisht këtë radhë nuk është faji i njerëzve, por i balenave Orka. [2] Më përpara kjo zonë ndaloi gjuetinë e balenave, por që prej vitit 2015 gjiri afrikan False Bay dhe Gansbaa vuri re shtimin e tyre në zonë.

[3] Pas kryerjes së studimeve të shumta, u gjendën prova që lidhin ardhjen e balenave me zhdukjen e peshkaqenëve. [4] Mbetjet e pesë peshkaqenëve të bardhë u gjendën në brigjet e Gansbaa-it dhe një tjetër u gjet në breg, i vlarë po në të njëjtën formë. [5] "Sa herë që ndodh diçka e tillë, kishte ulje të menjëhershme në numrin e peshkaqenëve dhe ende nuk e dimë përse", shprehet një shkencëtare biologe që është marrë me këtë studim.

[6] Në Kejptaun, biologja Alison Kock është duke studiuar orkat që shihen duke ngrënë mëlçitë e peshkaqenëve. [7] Çuditërisht, i vetmi organ që konsumohet është mëlçia. [8] Në mënyrë mbresëlënëse, orkat hapin një vrimë në krahërorin e peshkaqenëve dhe çuditërisht orkat e dinë vendndodhjen e saktë të mëlçisë. [9] Por mbase do të habiteshit nëse do të mësonit se peshkaqenët, çuditërisht, nuk janë për njeriun as aq të frikshëm, as aq të rrezikshëm sa keni menduar deri më sot. [10] Për më tepër, një video nga sulmi i vitit 1997 sugjeron që orkat e Afrikës së Jugut, balenat vrasëse, po kryejnë të njëjtin veprim ndaj peshkaqenëve.


[11] Një nga atraksionet më të mëdha turistike është të parit e peshkaqenëve në Afrikën e Jugut. [12] Kjo ndodh ose nga anijet, ose duke zbritur me një kafaz nën ujë, nga ku vëren shumëllojshmërinë e këtyre banorëve nënujorë.

1. Në përcaktimin e një studiuesi të revistës *Premier* pohohet se çdo vit: **1 pikë**
- A) kapen nga njerëzit rreth 100 milionë peshkaqenë.
 - B) ndodhin 75 sulme peshkaqenësh të paprovokuara.
 - C) 10 prej sulmeve mbi peshkaqenët janë fatale.
 - D) rritet mbi 110 euro çmimi i supës me pendë peshkaqeni.
2. Rrethoni pjesën e trupit të një peshkaqeni që vlerësohet më shumë nga aziatikët. **1 pikë**
- A) Bishti.
 - B) Pendët.
 - C) Kraharori.
 - D) Mëlçia.
3. Cila nga fjalitë e mëposhtme përmban një ndërhyrje subjektive nga ana e autorit? **1 pikë**
- A) Anëmbanë botës çdo vit ndodhin mesatarisht 75 sulme peshkaqenësh të paprovokuara.
 - B) Pas kryerjes së studimeve të shumta, u gjendën prova që lidhin ardhjen e balenave me zhdukjen e peshkaqenëve.
 - C) Sigurisht me peshkaqenët nuk bëhet shaka.
 - D) Shumica e peshkaqenëve kapen për t'u marrë pendët notuese, që disa aziatikë i vlerësojnë shumë.
4. Cila fjali e paragrafit të parafundit përmban një informacion që nuk është në të njëjtën linjë logjike me përmbajtjen e paragrafit? **1 pikë**
- A) Fjalia [7].
 - B) Fjalia [8].
 - C) Fjalia [9].
 - D) Fjalia [10].
5. Koherenca e paragrafit të parafundit dëmtohet nga përsëritja e pamotivuar e fjalës: **1 pikë**
- A) mëlçisë.
 - B) orkat.
 - C) çuditërisht.
 - D) është.
6. Cila nga fjalitë nuk është ndërtuar në përputhje me rregullat e gramatikës së gjuhës shqipe? **1 pikë**
- A) "Sa herë që ndodh diçka e tillë, kishte ulje të menjëhershme në numrin e peshkaqenëve dhe ende nuk e dimë përse", shprehet një shkencëtare biologe që është marrë me këtë studim.
 - B) Pas kryerjes së studimeve të shumta, u gjendën prova që lidhin ardhjen e balenave me zhdukjen e peshkaqenëve.
 - C) Një video nga sulmi i vitit 1997 sugjeron që orkat e Afrikës së Jugut po kryejnë të njëjtin veprim ndaj peshkaqenëve.
 - D) Një nga atraksionet më të mëdha turistike është të parit e peshkaqenëve në Afrikën e Jugut.

7. Në fjalinë: *Mbetjet e pesë peshkaqenëve të bardhë u gjendën në brigjet e Gansbaa-it dhe një tjetër u gjet në breg, i vrarë po në të njëjtën formë*, fjala me të zeza i referohet: **1 pikë**
- A) gjithë grupit emëror të kryefjalës së fjalisë.
B) vetëm kryefjalës së fjalisë (mbetjet).
C) përcaktorit (e peshkaqenëve).
D) rrethororit (në brigjet).
8. Nëse në fjalinë [3] rrethorori do të zëvendësohej me një fjali nënrenditëse, pa dëmtuar kuptimin e saj, cili do të ishte varianti i saktë? **1 pikë**
- A) Ngaqë u kryen studime të shumta, u gjendën prova që lidhin ardhjen e balenave me zhdukjen e peshkaqenëve.
B) Nëse kryheshin studime të shumta, do të gjendeshin prova që lidhin ardhjen e balenave me zhdukjen e peshkaqenëve.
C) Me qëllim që të kryheshin studime të shumta, u gjendën prova që lidhin ardhjen e balenave me zhdukjen e peshkaqenëve.
D) Pasi u kryen studime të shumta, u gjendën prova që lidhin ardhjen e balenave me zhdukjen e peshkaqenëve.
9. Në fjalinë [9] mbiemrat: *të frikshëm* dhe *të rrezikshëm*, lidhen mes tyre me lidhëza bashkërenditëse: **1 pikë**
- A) shtuese.
B) veçuese.
C) kundërshtuese.
D) përmbyllëse.
10. Nëse do ta zgjerohim fjalinë [3] me një përcaktor të veçuar, struktura e saktë do të ishte: **1 pikë**
- A) Pas kryerjes së studimeve të shumta, u gjendën prova, që plotësonin njëra-tjetrën, të cilat lidhin ardhjen e balenave me zhdukjen e peshkaqenëve.
B) Pas kryerjes së studimeve të shumta, u gjendën prova, mjaft të dobishme për vërtetësinë e tyre, që lidhin ardhjen e balenave me zhdukjen e peshkaqenëve.
C) Pas kryerjes, kohë mbas kohe, të studimeve të shumta, u gjendën prova që lidhin ardhjen e balenave me zhdukjen e peshkaqenëve.
D) Pas kryerjes së studimeve të shumta, u gjendën prova që lidhin, në mënyrë të drejtpërdrejtë e me të dhëna shkencore, ardhjen e balenave me zhdukjen e peshkaqenëve.
11. Në cilën nga fjalitë kemi përshtatje të gabuar mes gjymtyrëve kryesore të fjalisë? **1 pikë**
- A) Mbetjet e pesë peshkaqenëve të bardhë u gjendën në brigjet e Gansbaait.
B) Sipas studiuesve të tregut, furnizimi i tregut fitimprurës aziatik ka çuar në praktikën mizore dhe shpërdoruese të "gjuetisë së pendëve".
C) Më përpara kjo zonë ndaloj gjuetinë e balenave, por që prej vitit 2015 gjiri afrikan False Bay dhe Gansbaa vuri re shtimin e tyre në zonë.
D) Një nga atraksionet më të mëdha turistike është të parit e peshkaqenëve në Afrikën e Jugut.

12. Për cilën nga alternativat është e përshtatshme skema e mëposhtme?

1 pikë



- A) Në Kejptaun, biologja Alison Kock është duke studiuar orkat që shihen duke ngrënë mëlçitë e peshkaqenëve.
- B) Këto sulme që bëjnë bujë, dhe imazhi i keq që përcjellin filmat për peshkaqenin, bëjnë të krijohet ideja se ai është njerëzor.
- C) Shkencëtarët vërejnë se, në rast se do të pakësoheshin shumë, do të duheshin vite që ata ta merrnin veten.
- D) Supa me pendë peshkaqeni është një ushqim i rrallë e i shtrenjtë dhe një tas mund të kushtojë edhe 110 euro.

13. Në fjalinë: *Për më tepër, një video nga sulmi i vitit 1997 sugjeron që orkat e Afrikës së Jugut, balenat vrasëse, po kryejnë të njëjtin veprim ndaj peshkaqenëve, fjalët e nënvizuara janë:*

1 pikë

- A) përcaktor i veçuar.
- B) ndajshtim i veçuar.
- C) rrethor i veçuar.
- D) përcaktor kallëzuesor i veçuar.

14. Cili është informacioni që ju bën më shumë përshtypje në paragrafin e dytë dhe të tretë të këtij teksti? Jepni tri arsye për të shpjeguar zgjedhjen tuaj.

3 pikë

15. Cilat janë dy arsyet e parashtruara në tekst që ndikojnë në frikën e njeriut nga peshkaqenët?

2 pikë

16. Analizoni, përmes shembujve në fragment, katër nga tiparet e gjuhës së tekstit.

4 pikë

17. Si ndihmojnë ilustrimet për të përcjellë më mirë informacionin e këtij teksti? Sillni tri argumente për të mbështetur qëndrimin tuaj. **3 pikë**

PJESA II

Teksti letrar

Balzak: Xha Gorio (fragment)

Vitin e katërt që kur ishte vendosur në rrugën Njëvë-Sent-Zhënëvievë, ai nuk ngjante fare me Gorionë e parë. Fabrikanti i fideve, që ishte atëherë gjashtëdhjetë e dy vjeç e që nuk dukej as dyzet, borgjezi tërë tul e dhjamë, i qeshur e i gëzuar, i hedhur e i gjallë, saqë habiteshin gjithë sa e shikonin, e që, kur bënte buzën në gaz, dukej akoma më i ri, tani tregonte si një plak shtatëdhjetëvjeçar, i hutuar e i zbehtë, të cilit i dridheshin këmbët. Sytë e tij të kaltër, dikur aq të gjallë, u bënë si të shpëlarë, u zbehën, nuk lotonin më dhe rrethi i tyre i kuq dukej sikur kullonte gjak. Disave u kallte datën, të tjerëve u ndillte mëshirë. Ca studentë të mjekësisë, kur vunë re se i qe varur buza e poshtme dhe mbasi u munduan për një kohë të gjatë që t'i nxirrnin ndonjë fjalë, thanë se atij i kishin rrjedhur trutë e ishte bërë matuf. Një mbrëmje, kur zonja Voker i tha duke dashur të tallej me të e duke vënë në dyshim atësinë e tij: "Si është puna, nuk vijnë më vajzat t'ju shohin?", xha Gorio i hodh përpjetë, sikur e zonja e shtëpisë ta kishte shpuar me majën e një hekuri.

- Vijnë ngandonjëherë, - u përgjigj ai me zë të mallëngjyer.
- Ah! ah! gjene i shikoni ngandonjëherë? – thirrën studentët.- Bravo, xha Gorio!

Po plaku nuk i dëgjoji talljet që shkaktoi me përgjigjen e tij; ai u krodh përsëri aq shumë në mendime, saqë kush e shikonte ashtu përciptazi e merrte për një plak matuf të cilit i kishin rrjedhur trutë. Po ta kishin njohur mirë xha Gorionë, ndoshta ata mund të interesoheshin më tepër për gjendjen e tij shpirtërore dhe fizike, po kjo qe një punë shumë e vështirë për ta, diçka që ata s'mund ta bënë. Nuk qe punë e zorshme të mësohej nëse Gorioi pati qenë me të vërtetë fabrikant fidesh dhe gjer në ç'shumë arrinte pasuria e tij, por pleqtë e plakat kureshtarë nuk dilnin jashtë lagjes, ata rronin në pension, si ato gocat e detit ngjitur pas shkëmbit. Sa për njerëzit e tjerë, ata i rrëmbente rryma e jetës pariziane dhe, me të dalë nga rruga Njëvë- Sent- Zhënëvievë, e harronin fare plakun e gjorë, me të cilin talleshin. Për këta njerëz mendjengushtë, si dhe për të rinjtë e shkujdesur, një mjerim i tillë i hidhur dhe një matufepsje e tillë e xha Gorioit s'kishin të bënë me asnjë lloj pasurie e aftësie. Sa për gratë që ai i quante vajzat e tij, të gjithë bashkoheshin me mendimin e zonjës Voker që thoshte me atë logjikën e ashpër të atyre plakave që s'u pushon gjuha gjithë kohën dhe që pandehin se i marrin me mend të gjitha:

- Po të kishte vajza aq të pasura xha Gorioi sa dukeshin të gjitha gratë që kanë ardhur ta shohin, nuk do të rrinte në shtëpinë time në katin e tretë, me dyzet e pesë franga qira në muaj, dhe nuk do të dilte i veshur si varfanjak.

Asgjë nuk mund t'i përgënjeshtrohte këto arsyetime prandaj, andej nga fundi i nëntorit 1819, kohë në të cilën shpërtheu kjo dramë, të gjithë qiraxhinjtë e pensionit kishin formuar një mendim të prerë për plakun e gjorë. Për ta ai s'kishte pasur kurrë as vajzë, as grua dhe aq shumë kishte abuzuar në qejfe, saqë tani qe bërë një ligavec, një molusk në formë njeriu, që duhej klasifikuar në kasketiferet¹, thoshte një nëpunës i muzeumit, një nga ata që vinte në pension vetëm për të ngrënë.

¹ Parody burleske e termave që përdoren në histori natyre për klasifikimin e shtazëve.

18. Drama e Gorioit u shfaq:

1 pikë

- A) gjatë periudhës së nëntorit.
- B) në muajin janar.
- C) në stinën e pranverës.
- D) gjatë viteve të luftës.

19. Studentët e mjekësisë, nisur nga pamja e xha Gorioit, mendonin se ai: **1 pikë**
- A) ishte i inatosur me vajzat e tij.
 - B) dukej i lodhur nga jeta e mundimshme.
 - C) kishte humbur aftësinë e gjykimit të qartë.
 - D) kishte mënyrën e vet të shikimit të ngjarjeve.
20. Sipas fjalëve të autorit, nëse njerëzit do ta njihnin mirë xha Gorioin, ata: **1 pikë**
- A) do ta kishin trajtuar me më shumë dashuri.
 - B) do të ishin të rezervuar me talljet kundrejt tij.
 - C) do ta kishin kuptuar që atë e vizitonin vajzat e tij.
 - D) do të ishin më shumë të interesuar për gjendjen shpirtërore të tij.
21. Zbuloni në fragment dy ndjesitë që kanë njerëzit, kur ndeshen me pamjen e xha Gorioit. **1 pikë**
- A) Dashuria dhe urrejtja.
 - B) Dhimbja dhe trazira.
 - C) Neveria dhe mëshira.
 - D) Respekti dhe përbuzja.
22. Cili është përcaktimi i narratorit për parizianët e kohës? **1 pikë**
- A) Mendjengushtë dhe të shkujdesur.
 - B) Punëtorë dhe të shkathët.
 - C) Të mençur dhe kreativë.
 - D) Simpatikë dhe interesantë.
23. Mjetet stilistike që përdor Balzaku për të cilësuar banorët e Parisit janë: **1 pikë**
- A) epitetet.
 - B) krahasimet.
 - C) metaforat.
 - D) metonimitë.
24. Zonja Voker në fragment përfaqëson shtresën e: **1 pikë**
- A) qiraxhinjve të varfër, që përpiqen t'u mbijetojnë rrethanave të vështira të jetës së tyre.
 - B) sipërmarrësve të mëdhenj kapitalistë, që shfrytëzojnë masat e varfra.
 - C) qiramarrësve koprracë, të zhytur në llumin e mjediseve të ndotura si vetë ata.
 - D) tregtarëve të pasur, që majmen me gjakun e popullit.

25. Xha Gorioi (në fragment) flet vetëm një herë. Shpjegoni, përmes dy detajeve që vini re në replikën e tij, gjendjen shpirtërore të xha Gorioit. **3 pikë**

26. Balzaku është mjeshtër i karakterizimit të personazheve, qofshin ata protagonistë ose jo. Zbuloni një nga tiparet e zonjës Voker. Shtjelloni dy prej teknikave të karakterizimit të personazhit që përdor autori për të zbuluar këtë tipar të saj. **3 pikë**

27. Në disa momente përgjatë fragmentit, autori duket sikur ndërhyt drejtpërdrejt me qëndrimin e tij ndaj Gorioit. Cili është epiteti që përdor ai për personazhin, që na bën të gjykojmë sa më sipër? Shpjegoni gjetjen tuaj përmes shembujve përkatës në fragment. **2 pikë**

Epiteti:

Shpjegimi:

28. Në paragrafin e fundit shfaqet një personazh shumë sporadik. Zbuloni një tipar të karakterit të tij dhe analizoni *mjetet* (detaje/figura stilistike) që përdor autori për të nxjerrë në pah këtë tipar. **3 pikë**

Tipari i personazhit:

Mjetet që përdor autori:

29. Komentoni *mënyrën* se si autori e përshkruan shndërrimin e xha Gorioit në paragrafin e parë. **3 pikë**

30. Interpretoni fjalët e autorit në raport me mjedisin ku zhvillohen ngjarjet: "*pleqtë e plakat kureshtare nuk dilnin jashtë lagjes, ata rronin në pension, si ato gocat e detit ngjitur pas shkëmbit..*". **1 pikë**

31. Ka momente në fragment ku hidhet dritë mbi karakterin e vajzave të Gorioit. Shpjegoni përmes një rasti një nga tiparet e tyre. **1 pikë**

32. Në fragment përmendet që Gorioi kishte qenë fabrikant fidesh dhe në tërë romanin nuk sillen hollësi të prejardhjes së pasurisë së tij. A do të ishin ato të nevojshme në subjektin e veprës? Shpjegoni arsyen. **1 pikë**

33. Gjeni mjetin stilistik të shprehur në fjalië: -Vijnë ngandonjëherë, - u përgjigj ai me zë të mallëngjyer. Tregoni klasat e fjalëve me të cilat ky mjet stilistik është formuar. **3 pikë**

Mjeti stilistik:

Klasat e fjalëve:

Shënim: Faqja në vijim nuk do të merret në konsideratë nga komisioni i vlerësimit. Ajo shërben për të shkruar draftin e esesë.